


ËNDËRRAT TONA



DEMOKRATIKE

NE JEMI ZËRI I DEMOKRACISË

ERJON (10), ALBAN (10), SAMIR (10), AULONA (10), MIRJETA (10), QENDRESA (10)



Demokracia e sotme

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje. Demokracia është një formë e qeverisjes, në të cilën shumica e njerëzve e ushtrojnë sovranitetin e tyre, drejtpërdrejtë nëpërmjet referendumeve ose me anë të zgjedhjes së përfaqësuesve. Demokracia është shfaqur në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë në vitin 507 para lindjes së Krishtit. Në atë kohë të varfërit dhe gratë nuk kishin të drejtën e votimit. Atë të drejtë e kishin vetëm burrat e pasur. Me ndryshimin e kohës dhe të historisë kanë ndryshuar gjërat. Tani, kanë të drejtë i gjithë populli të votoj në procesin zgjedhor. Populli i Kosovës mund të votoj në procesin zgjedhor mbi moshën 18 vjeçare. Aty votohen kandidatët për

deputet të cilët janë përfaqësuesit e popullit.

Janë dy sisteme të demokracisë përfaqësuese: sistemi parlamentar dhe sistemi presidencial. Në sistemin parlamentar qytetarët votojnë deputetët, kurse në atë presidencial votohet Presidenti drejtpërdrejtë.

Liria, respekti, të drejtat e barabarta, toleranca, ndihma ndaj njëri-tjetrit, janë disa prej elementeve të demokracisë. Me fjalën liri kuptojmë shprehjen e lirë të mendimit, kurse me fjalën tolerancë kuptojmë respektin dhe mirësjelljen ndaj njëri-tjetrit. Të drejtat e barabarta janë: e drejta e arsimimit, shoqërimit, argëtimit, shëndetësisë, e drejta e punësimit, e lojës, kujdesit mjekësor etj. Porosia jonë është ta kultivojmë dhe respektojmë demokracinë deri në maksimum. Mos e lëndoni demokracinë!



E drejta për të shëtitur



Ne jemi e ardhmja e Kosovës

AKTIV NË DEMOKRACI

TRINDA (11), ANESA (11), LEDION (10), ARGJENT (11), LEOTRIM (10), GENTI (10), DIELLZA (10)

Si fëmijë ne e ndërtojmë të ardhmen. Në artikullin tonë do të mësoni se si duhet të jeni qytetarë aktiv dhe shembullor. Ju ftojme të lexoni artikullin më poshtë

Ne jemi qytetarë të Kosovës. Vendi ynë është demokratik dhe ne si qytetarë të tij kemi të drejta dhe përgjegjësi. Ne kemi të drejtë të shkollohemi, të luajmë, të shprehemi lirshëm etj. Mirëpo, me të drejtat vijnë edhe përgjegjësitë. Ne në shkollë përgjegjësi e kemi ta ruajmë ambientin, të mos flasim pa rend, të dëgjojmë dhe respektojmë të tjerët etj. Gjithashtu, mund të jemi edhe qytetarë aktiv. Për shembull, mund të jemi aktiv duke pastruar ambientin, duke marrë pjesë në aktivitete të ndryshme vetëdijësuese etj. Ne duhet të jemi qytetarë shembullor dhe ti ndihmojmë të tjerët. Nuk duhet të harrojmë se duhet ta respektojmë ligjin, sepse kështu i kryejmë përgjegjësitë. Në të ardhmen, ne do të jemi qytetarë që i kryejmë të gjitha përgjegjësitë tona.



Autorët e këtij artikulli. Shembull i qytetarëve aktiv



Ambienti i pastër është përgjegjësi e jona si dhe është gjysma e shëndetit



E drejtë e jona është të strehohemi dhe të kemi familje



Demokracia na pranon ashtu siç jemi

KUVENDI YNË DEMOKRATIK


LEON (10), OLTİ (10), ERVA (10), BJONDINA (10), LORESA (10), DIAR (11)

Demokracia është synimi ynë për një të ardhme sa më të mirë

Kuvendi është shtëpia e dytë e popullit. Në Kuvend zgjidhen problemet e brendshme të një shteti. Aty punojnë deputetët dhe Kryetari i Kuvendit. Ndryshe Kuvendi quhet Pushtet Legjislativ, sepse aty miratohen ligjet. Ai ndikon edhe në zgjedhjen e Presidentit të shtetit. Kuvendi i Republikës së Kosovës përbëhet prej 120 deputetëve të cilët janë nga parti të ndryshme dhe kanë për detyrë të punojnë për vendin tonë demokratik. Ne në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kemi tre lloje të votimeve, e ato janë: me dorë, me shkrim dhe në mënyrë elektronike. Ne kur të rritemi dëshirojmë që Kuvendi i Kosovës të vazhdoj të jetë demokratik, sepse vetëm në këtë mënyrë zhvillohet vendi ynë.



Autorët e artikullit



E drejta e shkollimit



Një deputete në foltoren e Kuvendit




Gazetarët duke bashkëpunuar




Deputeti i popullit



Demokracia ka shumë ngjyra. I pranon të gjitha racat



Kuvendi e ushtron funksionin legjislativ



Oqytetarë aktiv për të mirën e vendit tonë



Në demokraci të gjithë jemi të barabartë. Të gjithë kemi të drejtë të jemi të lumtur dhe gëzojmë të drejta që nuk mohohen



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org